REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:042369

Datë: 13.11.2020

Numri i dokumentit: 01271093

P.nr.858/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P. , gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurës D. Q. , sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II.nr. 2834/16 të dt.18.8.2017, për shkak të veprës penale : ndryshim i njehsorit të shërbimeve nga neni 323 par 1 të KPRK-së , pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në pranin e të pandehurës D. Q. dhe të prokurorit të shtetit Suada Hamza , dhe të me dt.13.11.2020 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

A K T GJ Y K I M

E pandehura D. Q. e lindur me dt. 01.6.1959 në fsh. ..... Komuna e Pejës, me vendbanim në Pejë rruga ……., e bija S. dhe nënës T. e gjinisë H. , e njohur me dokument identifikues numër ....., ka të kryer shkollën e mesme, e pa punë , amvise , e pa martua, e gjendjes së mesme e ekonomike, kinse e pa dënuar më parë nga gjykata, shqiptare, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTORE

Për arsye se :

Prej datës 20.4.2014, në vazhdimësi deri me dt. 20.4.2015, në Pejë , pengon njehsorin elektrik në regjistrimin e sakët të energjisë së shpenzuar , në dëm të kompanisë .... , në atë mënyrë që i pandehuri fillimisht njehsorin elektrik me shifrën DPE ..... ia heq pllombat shtetërore dhe manipulon me shifrën e tretë nr. 9, shifra e katërt nr. 4.6, shifra e pestë nr. 9.1 , shifra e pestë nr. 9.1 në T1, ashtu që kompaninë e lartcekur e dëmton.

-me çka ka kryer vepër penale: ndryshim i njehsorit të shërbimeve nga neni 323 par 1 të KKPR-së

Prandaj gjykata të pandehurës konform nenit 41, 85, 86 dhe nenit 323 par 1 të KPK-së I SHQIPTON

VËREJTJE GJYQËSORE

Me të cilën të pandehurës i behët me dije se ka kryer vepër të dëmshme dhe të rrezikshme që përbënë vepër penale për të cilën nëse ajo sërish e përsëritë gjykata do ti shqiptoi sanksion më të rëndë penal.

E pandehura për shkak të gjendjes së varfër ekonomike lirohet nga pagimi i paushallit gjyqësor .

E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

2018:042370

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt. 18.8.2017 kundër të pandehurës D. Q. ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.2834/16 , për vepër penale : ndryshim i njehsorit të shërbimeve nga neni 323 par 1 të KPRK-së , duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurën ta shpallë fajtore , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestar e pandehura – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasoja e pranimit përkatësisht të mos pranimit të fajësisë- e ka pranuar fajësinë. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit, i bindur se pranim fajësinë e pandehura e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe asnjë mënyrë e ka pranuar.

Meqenëse e pandehura e pranoj fajësinë gjyqtari kaloj në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë renduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e sinqertë të fajësisë , që është rrethanë veçanërisht lehtësues, pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë , pa denushmerinë e më mëparshme, e sidomos faktin se e pandehura, faktin se e pandehura vuan nga një sëmundje e rënë, gjendjen jo të mirë ekonomike , dhe kësisoj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitvin e aktgjykimit ndaj të pandehurës do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 453 të KPPRK-së

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin e rregullt civil është marrë konform nenit 463 të KPPRK-së .

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë. 13.11.2020.

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

<u>KËSHILLA JURIDIKE</u>
Kundër këtij aktgjykimi lejohet
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë
E përmes kësaj Gjykate .

2018:042370